



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI



DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE ISJP-A

Nr. 1194/3 prot.

Tiranë, më 18/10/2022

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik
Tiranë

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Rektorati i Universitetit të Arteve shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë si më poshtë:

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

➤ **NJËSIA BAZË PIKTURË:**

1. Lektor/As. Lektor për lëndët: Pikturë Kavaleti, Nudo, Vizatim dhe Pikturë (1 vend);

➤ **NJËSIA BAZË PIKTURË:**

1/2. Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo kandidat, për pozicionin e punës: Lektor/As. Lektor në Programin e studimit Pikturë Kavaleti, në lëndët Pikturë Kavaleti, Nudo, Vizatim dhe Pikturë, në dosjen e tij duhet të ketë:

- Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar vendi për të cilin ai konkurren;
- Diplomë origjinale + fletë notash (shkollë e lartë në **Programin e Studimit Pikturë** mesatare e përgjithshme mbi 8), ose fotokopje e noterizuar, e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MAS&R;
- Jetëshkrim (CV) i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
- Të ketë përvojë në mësimdhënie IAL (arsimore artistike) jo më pak se 3 (tre) vite;
- Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar vendi për të cilin ai konkurren;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI



DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE ISJP-A

- Diplomë origjinale + fletë notash (shkollë e lartë në profilin përkatës, (mesatare e përgjithshme mbi 8)/fotokopje e noterizuar, e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MAS&R;
- Të ketë përfunduar ciklin e tretë të studimeve “Doktor”, në specialitetin për të cilin konkurron;
- Jetëshkrim (CV) i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
- Të ketë përvojë pune në realizimi ne veprave artistike dhe projekteve me specifike të njëjtë me lëndën të ngjashme;
- Të ketë përvojë minimum 3 vjet, në mësimdhënie në arsimin e lartë në fushën përkatëse, brenda/jashte Shqipërisë;
- Të ketë aktivitet të dukshëm artistik,të dëshmuar me katalogë, artikuj, postera etj.;
- Të ketë njohuri të thella mbi teknikat e Pikturës;
- Të jetë pjesmarrës në takime e konferenca, workshope kombëtare dhe ndërkombëtare me institucione të fushës;
- Të ketë dëshmi/dokumentacion që vërteton angazhimin e tij në tekste mësimore, hartime programesh, artikuj etj...;
- Të dëshmojë etikë të lartë profesionale dhe morale;
- Të mos ketë penalizime nga punëdhënësit e mëparshëm në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënie me kolegët;
- Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (me dëshmi nga institucionet certifikuar nga MAS);
- Dy referenca nga profesorë me tituj te fushës;
- Dokumente që vërtetojnë përvojën në punë (fotokopje të librezës së punës);
- Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit/Çertifikatë familjare;
- Të deklarojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata te tre muajve te fundit/ vetëdeklarim;
- Dëshmi e gjendjes mjekësore.

Kandidati për konkursin duhet të plotësojë këto kritere:

- Kërkesë ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkurron;
- Diplomë origjinale + fletë notash/fotokopje e noterizuar (shkollë e lartë në profilin përkatës per arte) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI



DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE ISJP-A

- Diplomë Doktorature origjinale/fotokopje e noterizuar (në specialitetin për të cilin konkurren) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;
- Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; pervoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet...etj);
- Një projekt – program për lëndën për të cilën konkuron;
- Diploma ose dëshmi në veprimtari të ndryshme profesionale;
- Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj/bëjnë përjashtim kandidatët që kanë kryer studimet jashtë shqipërie;
- Të vërtetojë që ka përvojë mësimdhënie në IAL;
- Dy referenca nga profesorë/personalitate te fushës;
- Vërtetim nga qendra/t e punës së mëparshme që nuk ka penalitete në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënieve me kolegët;
- Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
- Çertifikatë familjare;
- Të deklarojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- Dëshmi e gjendjes mjeksore.


Konkurimi për punonjës mësimorë sa më lartë do të zhvillohet në dy Faza:

(Vlerësimi maksimal 100 pikë)

- Faza e parë - Shqyrtimi i dosjes së kandidatit;
(Vlerësimi gjithsej 50 pikë)
- Faza e dytë - Mësim i Hapur/Intervistë.
(Vlerësimi gjithsej 50 pikë)

Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e AL në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Procedurave Administrative, Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar. Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Universitetin e Arteve nga data **18/10/2022** deri më datë **24/10/2022** ora **14.00**.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI



DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE ISJP-A

Prof. Kastriot ÇAUSHI

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE

